

UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

December 12 | Workshop: The German Supply Chain Due Diligence Act

December 13 | Business After Hours

December 20 | Media's Crucial Role in Distinguishing Customer Service Centers from Deceptive Practices in Call Centers

Director's Note

Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,

OEGJK këtë javë është angazhuar në aktivitete të ndryshme duke dhënë kontributin e saj në dëgjime publike, arsimin dhe aftësimin profesional dual si dhe organizimin e konferencës në ndikimin e liberalizimit të vizave: Sfidat dhe mundësitë e bizneseve nga Kosova.

Këtu është një përmbledhje e ngjarjeve të aktiviteteve përgjatë kësaj jave:

U mbajt konferenca "Ndikimi i Liberalizimit të Vizave: Sfidat dhe Mundësitë për Bizneset në Kosovë"

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK-KDWW), bashkë me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM Kosovo), Friedrich-Ebert-Stiftung në Prishtinë (FES), si dhe Kantar (Index Kosova), organizuan konferencën "Ndikimi i Liberalizimit të Vizave: Sfidat dhe Mundësitë për Bizneset në Kosovë".

Ngjarja mbledhi figura të rëndësishme nga qeveria, organizatat ndërkombëtare dhe komuniteti i biznesit. Ajo filloi me një diskutim mbi liberalizimin e vizave dhe lëvizjen e fuqisë punëtore në Kosovë, më pas me një diskutim tjetër me ekspertë dhe përfaqësues të biznesit mbi pasojat ekonomike të rritjes së lëvizjes së fuqisë punëtore, teksa në fund paneli i tretë dha

Dear members of the German-Kosovar Business Association,

KDWW this week has been actively engaged in various activities, contributing to public hearings, VET, and organizing a conference on the impact of visa liberalization: Challenges and opportunities for businesses from Kosovo

Here's summary of events and activities throughout this week:

The conference "Impact of Visa Liberalization: Challenges and Opportunities for Businesses in Kosovo" was held

The German-Kosovar Business Association (KDWW), together with the International Organisation for Migration, Friedrich-Ebert-Stiftung as well as Kantar organized the conference "The Impact of Visa Liberalization: Challenges and Opportunities for Businesses in Kosovo".

The event brought together influential figures from the government, international organizations, and the business community. The conference began with a discussion on visa liberalization and labor mobility in Kosovo, followed by another discussion with experts and business representatives on the economic implications of increased labor mobility. The third panel gave

rekomandime për politikat e migracionit dhe punësimit.

Znj. Nora Hasani, drejtoreshë ekzekutive e OEGJK-KDWW, tha se rezultati më i madh i kësaj konference është se u analizuan tema të rëndësishme për sektorin privat, në lidhje me migrimin e rregullt dhe mungesën e fuqisë punëtore.

Znj. Anna Rostocka, shefe e misionit të IOM Kosovo, e vlerësoi konferencën për nxitjen e diskutimeve mbi ndikimin e liberalizimit të vizave në punë dhe peisazhin socio-ekonomik të Kosovës, duke mundësuar palëve të interesuara të zhvillojnë zgjidhje praktike.

Pjesëmarrës tjetër në konferencë ishin përfaqësues nga Qeveria e Kosovës, zëvendëskryeministri i parë z. Besnik Bislimi, i cili e vlerësoi ngjarjen si një gur themel në fushatën para liberalizimit të vizave. Teksa, Ambasadori gjerman z. Jörn Rohde, theksoi rëndësinë e liberalizimit të vizave, së bashku me kompani dhe organizata të ndryshme pjesëmarrëse.

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare do të ndajë konkluzionet e konferencës me të gjitha palët kyçe, duke kontribuar në qasje optimale për respektimin e rregullave të liberalizimit nga individët dhe bizneset në Kosovë.

recommendations for migration and employment policies.

Nora Hasani, Executive Director of KDWW, said that this conference's biggest outcome is that it analysed important topics for the private sector, in regard to regular migration and the lack of labor force.

Ms. Anna Rostocka, Chief of Mission of IOM Kosovo, praised the conference for fostering discussions on visa liberalization's impact on labor and Kosovo's socioeconomic landscape, enabling stakeholders to develop practical solutions

Other participants in the conference were representatives from the Government of Kosovo, First Deputy Prime Minister Besnik Bislimi, who highlighted the event as a cornerstone in the pre-visa liberalization campaign. German Ambassador Mr. Jörn Rohde, emphasizing the importance of the visa liberalization, along with various companies and organizations.

The German-Kosovar Business Association will share the conference conclusions with all key stakeholders, contributing to the optimal approach for adhering to liberalization rules by individuals and businesses in Kosovo.

Fotografi nga konferenca "Ndikimi i Liberalizimit të Vizave: Sfidat dhe Mundësitë për Bizneset në Kosovë"

Images from the conference "Impact of Visa Liberalization: Challenges and Opportunities for Businesses in Kosovo"





Punëtori nga OEGJK rreth Ligjit të zinxhirit të furnizimit të Gjermanisë

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare do të organizojë një punëtori që do të udhëhiqet nga drejtoresha znj. Nora Hasani rreth Ligjit të zinxhirit të furnizimit të Gjermanisë.

Duke qenë se ky ligj detyron që edhe kompanitë kosovare, që punojnë me Gjermani dhe eksportojnë atje, të përshtaten me rregullat e reja, ka ardhur deri tek iniciativa për këtë workshop.

Përgatitja e kompanive shihet të jetë cruciale që mos të humbin hapin e të bërit biznes me dhe në Gjermani. Punëtorja do të mbahet më 12 dhjetor nga ora 10:00.

Regjistrohuni në info@oegjk.org

OEGJK pjesëmarrëse në punëtorinë "Arsimi dual dhe mësimi në vendin e punës në Kosovë"

Këshilltarja për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dual në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare (KDWV-OEGJK), znj. Besarta Hyseni mori pjesë në punëtorinë me temën "**Arsimi dual dhe Mësimi në Vendin e Punës në Kosovë**", e cila u organizua nga GIZ gjerman dhe anëtarët e Komitetit të Donatorëve për Arsimin dhe Aftësimin dual: ADA, BMZ/GIZ dhe SDC.

Workshop by KDWV on the German Supply Chain Law

The German-Kosovar Business Association will organize a workshop led by Ms. Nora Hasani on the German Supply Chain Law.

Since this law requires Kosovar companies working with Germany and exporting there to adapt to new rules, the initiative for this workshop has been taken.

The preparation of companies is seen as crucial to not miss the opportunity to do business with and in Germany. The workshop will be held on December 12 from 10:00.

Register at info@oegjk.org.

The KDWV has participated in the workshop "Dual VET & Work-Based Learning in Kosovo"

Ms. Besarta Hyseni, Advisor for dual Vocational Education and Training (dVET) at the German-Kosovar Business Association (KDWV-OEGJK) participated in the workshop on "**Dual VET & Work-Based Learning in Kosovo**" organized by GIZ and members of the Donor Committee (DC) for dual Vocational Education and Training (dVET), ADA, BMZ/GIZ, and SDC.

Komiteti i Donatorëve mbështet reformat në arsimin dhe aftësimin profesional në Kosovë që prej shumë vitesh dhe qëllimi i punëtorisë ishte të qartësojë konceptet dhe terminologjinë rreth arsimit dual dhe mësimin në vendin e punës (MVP), të zhvillojë një të kuptuar të përbashkët mbi të dhe të ofroj një platformë për diskutim mbi implikimet dhe mundësitë për kontekstin e Kosovës.

The DC has been supporting the VET reform for many years, and the workshop aimed to clarify concepts and terminology around dual VET and Work-Based Learning (WBL), develop a common understanding, and provide a platform for discussion on the implications and possibilities for the context of Kosovo.

Bizneset e Kosovës në Forumin Ekonomik në Gjenevë

Me organizim të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës (MPJD) është organizuar më 2 dhjetor pjesëmarrja e bizneseve të Kosovës në Forumin Ekonomik në Gjenevë të Zvicrës.

Në Forumin Ekonomik të Gjenevës pjesëmarrëse ishin edhe disa kompani anëtare të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, të cilat kanë pasur rastin të rrjetëzohen me kompani dhe ndërmarrës që veproj në Gjenevë.

MPJD do të organizojë edhe forume tjera të ngjashme, ku i radhës do të jetë në Frankfurt të Gjermanisë më 9 dhjetor, në të cilin gjithashtu kompani anëtare të OEGJK-së do të marrin pjesë.

Kosovo businesses at the Economic Forum in Geneva

With the organization of the Ministry of Foreign Affairs and Diaspora of Kosovo (MPJD), the participation of Kosovo businesses at the Economic Forum in Geneva, Switzerland was organized on December 2nd.

Several member companies of the German-Kosovar Business Association participated in the Geneva Economic Forum, which had the opportunity to network with companies and entrepreneurs operating in Geneva.

The Ministry of Foreign Affairs will organize other similar forums, when the next one will be in Frankfurt, Germany on December 9th, in which also member companies of KDWV will be participating.

OEGJK mori pjesë në dëgjimin publik për Projektligjin për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti në Kuvendin e Kosovës ka mbajtur dëgjim publik lidhur me Projektligjin për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Përfaqësuesit e OJQ-ve dhe ata të shoqërisë civile, përfshirë znj. Eriola Muhaxhiri nga OEGJK,

KDWV participated in the public hearing on the Draft Law on the promotion of the use of renewable energy sources

The Committee for Economy, Industry, Entrepreneurship and Trade in the Assembly of Kosovo has held a public hearing regarding the Draft Law on the promotion of the use of renewable energy sources.

Representatives of NGOs and those of civil society, including Mrs. Eriola Muhaxhiri from

paraqitën qëndrimet, duke dhënë kështu vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, të cilat ishin të fokusuar në aspekte teknike, por edhe përmbajtësore për projektligjin e trajtuar.

Në përfundim të punimeve u tha që rekomandimet për këtë projektligj do të pranohen deri më 12 dhjetor në formë të shkruar.

KDWW, presented their positions, thus giving their remarks and suggestions, which were focused on technical aspects, but also content for the draft law addressed.

At the end of the work, it was said that the recommendations for this draft law will be accepted until December 12 in written form.



Mundësi përkrahjeje për festivalin “Mitrovica International Jazz Days”

“Mitrovica International Jazz Days” një aktivitet disa ditor me muzikë kualitative dhe punëtori që organizohet nga këngëtarja e njohur Rona Nishliu, duke u mbështetur në mundësinë e financimit të aktiviteteve me anë të Ligjit për Sponzorizim nëpërmes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Të gjithë kompanitë që kanë hapësirë për të ndihmuar në këtë formë mund të kontaktojnë në ronanishliu@gmail.com ose +383 44 234 941.

Opportunity of support for the “Mitrovica International Jazz Days”

Mitrovica International Jazz Days" is a multi-day event featuring high-quality music and workshops organized by the renowned singer Rona Nishliu, by relying on the possibility of financing activities through the Sponsorship Law, via the Ministry of Culture, Youth, and Sports.

Interested companies with the capacity to contribute in this way can contact at ronanishliu@gmail.com or +383 44 234 941.

YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV

BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday - Friday | 8.30 - 16.30



Greta Kazia

HR, Përgjegjëse për
Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for
Finance and
Membership

greta.kazia@oegjk.org




Besarta Hyseni

Udhëheqëse e
Departamentit mbështetje
dhe shërbime të anëtarëve
Këshilltare për Arsime
Profesional Dual (dVET)

Head of Market Entry &
Events
Advisor for dVET

besarta.hyseni@oegjk.org



Elena Elshani

Asistente Ekzekutive
Përfaqësuese për
Shërbimin e Ekspertëve
Seniorë (SES)

Executive Assistant
Senior Expert Service
Representative (SES)

elena.elshani@oegjk.org



Gonxhe Abazi

Udhëheqëse e
Departamentit për Avokim
dhe Marrëdhënie
Qeveritare
Head of Department for
Advocacy and Government
Relations

gonxhe.abazi@oegjk.org



Eriola Muhaxhiri

Këshilltare Ligjore

Legal Advisor

eriola.muahaxhiri@oegjk.org